

Data 15/07/2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Mbështetje për Programin Operacional 2026-2029: Paketa F- Shërbime Konsulence, Projektimi dhe Mbikëqyrje për permiresimin e transportit dhe aksesit nëpërmjet ndërhyrjeve në rrugët e bardha etj, Qarku (Elbasan, Korçë, Berat, Vlorë, Fier, Gjirokastrë)”.
KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 73300000-5; 71247000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: **27,185,372 lekë** pa TVSH, **289,175.32 Euro**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe”, autoriteti/enti kontraktor FSHZH ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik."

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e marrëveshjes kuadër në procedurën e prokurimit.

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: "Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet **financiare 2023, 2024, 2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika "b", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të marrëveshjes kuadër. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të

shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 41 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Ky kriter vërteton eksperiencën në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Përvoja e operatorit është një element i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qëndrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Në kuptim të nenit 41 të VKM-se 285/2021 vlerësohet vlera e kërkuar në masën jo më të vogël se 30 % të vlerës së përlogaritur të marrëveshjes që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. e cila është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës rrjedhimisht nuk sjellë kufizim të pjesëmarrjes në garë të operatorëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projekttime dhe mbikëqyrje të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

i- Licensat e kërkuara në projektim:

- | | |
|--------|--|
| 5 d: | Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino; |
| 6 a,b: | Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore;
Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore. |
| 7 a: | Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m; |
| 8 a,b: | Rilevime inxhinierike
Rilevime inxhinierike kadastrale. |
| 9 a,d: | Studim gjeologo-inxhinierik i trullit për objekte deri 5 kate Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët. |
| 10 e: | Projektim kabina elektrike në rrjetin shpërndarës - linja të tensioni të ulët – të mesëm. |

11 a: Sinjalistikë jondricuese në rrugë lokale, urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe dhe parkim.

Specialisti i mjedisit duhet të zotëroj certifikatë në përputhje me Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 i ndryshuar me Ligjin 128/2020.

Për të vertetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën e shoqërisë.

ii)-Licencat e kërkuara në mbikëqyrje

N.P – 1. Punime gjurmimi në tokë.

N.P – 4. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.

N.P – 5. Punime nëntoksore, ura e vepra arti.

N.P – 12. Punime të inxhinierisë së mjedisit..

iii)-Për mbikëqyrjen e punimeve speciale të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

N S – 1. Punime për prishjen e ndërtimeve.

N S – 6. Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.

N.S – 7. Barriera dhe mbrojtje rrugore.

N S – 9. Punime strukturore speciale.

N.S – 18. Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (VKM nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim).

-Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.201”, si dhe VKM Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale” dhe teknikisht në Termat e Referencës sipas tipologjisë. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve objekt të kontratës të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës shërbimin e projektimit dhe të mbikëqyrjes. Sa i përket shërbimit të projektimit Kategoritë e mesipërme janë përcaktuar

ne perputhje me Termat e Referencës tipologjinë e Ndërhryrjet e kësaj pakete do të përfshijnë: Rehabilitimi i zonave ku janë konstatuar rrëshqitje të terrenit, dëmtime të skarpatave, deformime të trupit të rrugës apo cenim i qëndrueshmërisë së veprave ekzistuese të artit, duke parashikuar masa inxhinierike për stabilizimin e terrenit dhe rikthimin e funksionalitetit të plotë të segmentit rrugor. Riprofilimi i rrugës, përmirësimi i bazamentit, vendosja ose rforcimi i shtresave stabilizuese, si dhe trajtimi i zonave ku janë evidentuar deformime, gropa, çarje apo humbje të materialit rrugor. Sistemimi dhe përmirësimi i kullimit të ujërave, veçanërisht në zonat e banuara dhe në segmentet me pjerrësi të madhe gjatësore, për të shmangur dëmtimin e trupit të rrugës dhe të shtresave mbajtëse. Ndërtimi, pastrimi ose ribërja e kanaleve anësore kulluese, përmirësimi i drejtimit të rrjedhjes së ujërave, rehabilitimi i tombinove ekzistuese dhe realizimi i elementeve të nevojshme për largimin efikas të ujërave sipërfaqësore nga platforma rrugore. Pastrimi, sistemimi dhe ribërja, sipas rastit, e bankinave anësore, duke i trajtuar ato si elemente mbështetëse të trupit të rrugës që kontribuojnë në mbrojtjen e shtresave rrugore, përmirësimin e drenazhimit dhe rritjen e sigurisë së qarkullimit. Ndërtimi ose rehabilitimi i mureve mbajtëse dhe pritëse, përforcimi i elementeve mbrojtëse ekzistuese, si dhe ndërhyrje të tjera të nevojshme për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes së infrastrukturës. Përmirësimi i shtresave rrugore në bazë të gjendjes fizike dhe teknike të rrugës ekzistuese, kapacitetit mbajtës të nënshtresave, nivelit të dëmtimeve dhe intensitetit të përdorimit të segmentit. Kombinimi i ndërhyrjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me problematikat specifike të çdo segmenti, me qëllim përmirësimin e funksionalitetit, qëndrueshmërisë dhe sigurisë së akseve rrugore për komunitetet përfutuese. Ndërkohë për shërbimin e mbikqyrjes se punimeve ne zbatim kategorite e mesiperme jane percaktuar ne perputhje me Termat e References dhe natyrën e kontratës sipërcituar.

2.3.3 Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet te paraqesin nje liste te stafit kryesor te meposhtem, te cilet duhet te kene nje marredhenie kontraktore me operatorin apo partnere ne rastin e nje bashkimi operatoresh. I gjithë stafi kryesor i kerkuar duhet te jete i licensuar ne sherbimet e projektimit dhe mbikqyrjes si dhe duhet te zoteroje licensat profesionale sipas kategorive te renditura me siper, perkatesisht per specialitetin qe mbulojne. Per çdo pozicion, operatoret jane te lire te propozojne me shume se nje kandidat, me qellim permbushjen e kriterave te kerkuara.

i)- Pozicionet e stafit te kerkuar jane::

Tabela per stafin

Stafi per sherbimin e projektimit dhe mbikqyrjes	Stafi i projektimit	Stafi i mbikqyrjes	Total
*Drejtues Projekti (Drejtues i grupit te projektimit) Projektues (inxhinier rruges, me pervoje ne varesi te projekteve specifike)	1		1
Projektues Rruges \ Inxhinier ndertimi	1	1	2
Projektues ura dhe vepra arti \ Inxhinier ndertimi	1	1	2
Projektues Hidroteknik	1	1	2
Projektues Elektrik	1		1
Projektues Gjeodet	1	1	2
Projektues Gjeolog	1	1	2
Projektues i sinjalistikes	1		1
Specialit Mjedisi	1		1
Kontrollor Cilesie		1	1
Kontrollor i volumeve te punes		1	1
Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE)		1	1

Total	9	8	17
--------------	---	---	----

ii) Licensat qe duhet te zoteroje stafi i projektimit:

Drejtues Projekti (Drejtues i grupit te projektimit)	*
Projektues Rrugesh	6 a,b;
Projektues Hidroteknik	5 d;
Projektues Ura dhe vepra arti	7 a
Projektues Gjeodet	8 a,b;

- Drejtues Projekti* duhet te jete (Projektues Rrugesh).
- Drejtuesi i Projektit, Projektuesi Vepra Arti, Projektuesi gjeodet, Projektuesi hidroteknik duhet të jenë pjese e stafit të shoqërisë dhe të figurojnë në listëpagesat e punonjesve të shoqërisë për periudhen 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- Inxhinier Ndertimi, Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Gjeodet, duhet të jenë pjese e stafit të shoqërisë dhe të figurojnë në listëpagesat e punonjesve të shoqërisë për periudhen 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit
- Operatori ekonomik do duhet që në cdo kantier të ketë një Inxhinier Rezident (per mbikeqyrjen).

Stafi i mësipërm duhet të jetë pjesë e stafit të propozuar për të ndjekur projektin dhe implementimin e punimeve. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti, për secilin prej specialistëve të lartpërmendur Operatoret Ekonomike duhet të paraqesin:

- kualifikimet arsimore (diplomat), kualifikimet profesionale (licencat profesionale), CV, Kontratë pune të vlefshme.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. _Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

-Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin public" i ndryshuar, në nenin 41 pika 4/b/cte VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates përshkrimit në Termat e Referencës. Ndërhyrjet e kësaj pakete do të përfshijnë: Rehabilitimi i zonave ku janë konstatuar rrëshqitje të terrenit, dëmtime të skarpave, deformime të trupit të rrugës apo cenim i qëndrueshmërisë së veprave ekzistuese të artit, duke parashikuar masa inxhinierike për stabilizimin e terrenit dhe rikthimin e funksionalitetit të plotë të segmentit rrugor. Riprofilimi i rrugës, përmirësimi i bazamentit, vendosja ose riforcimi i shtresave stabilizuese, si dhe trajtimi i zonave ku janë evidentuar deformime, gropa, çarje apo humbje të materialit rrugor. Sistemimi dhe përmirësimi i kullimit të ujërave, veçanërisht në zonat e banuara dhe në segmentet me pjerrësi të madhe gjatësore, për të shmangur dëmtimin e trupit të rrugës dhe të shtresave mbajtëse. Ndërtimi, pastrimi ose ribërja e kanaleve anësore kulluese, përmirësimi i drejtimit të

rrjedhjes së ujërave, rehabilitimi i tombinove ekzistuese dhe realizimi i elementeve të nevojshme për largimin efikas të ujërave sipërfaqësore nga platforma rrugore. Pastrimi, sistemimi dhe ribërja, sipas rastit, e bankinave anësore, duke i trajtuar ato si elemente mbështetëse të trupit të rrugës që kontribuojnë në mbrojtjen e shtresave rrugore, përmirësimin e drenazhimit dhe rritjen e sigurisë së qarkullimit. Ndërtimi ose rehabilitimi i mureve mbajtëse dhe pritëse, përforcimi i elementeve mbrojtëse ekzistuese, si dhe ndërhyrje të tjera të nevojshme për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes së infrastrukturës. Përmirësimi i shtresave rrugore në bazë të gjendjes fizike dhe teknike të rrugës ekzistuese, kapacitetit mbajtës të nënshtresave, nivelit të dëmtimeve dhe intensitetit të përdorimit të segmentit. Kombinimi i ndërhyrjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me problematikat specifike të çdo segmenti, me qëllim përmirësimin e funksionalitetit, qëndrueshmërisë dhe sigurisë së akseve rrugore për komunitetet përfituese”.

Sa i përket kërkesës për specialistin e mjedisit është e nevojshme që gjatë fazës së zbatimit të kontratës duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, për këtë qëllim subjekti duhet të jetë i certifikuar në përputhje me Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 i ndryshuar me Ligjin 128/2020. Specialisti i mjedisit është një kërkesë e vendosur nisur dhe nga rëndësia e objekteve dhe volumi i punimeve sipas standarteve e kushteve teknike.

Kërkesa për Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE) mbështet në ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 date 09.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontrates dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punedhenesi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punedhenes zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e perkohshme ose të levizshme, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes

Kërkesa për stafin teknik për shërbimin e mbikëqyrjes lidhet ngushtësisht me numrin e objekteve të kontrates së zbatimit dhe vëndndodhjen e tyre. Nevoja për inxhinierët në objekt/kantier është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit dhe bazuar në VKM nr. 610, datë 22.9.2022. Numri i stafit kryesor teknik për mbikëqyrjen është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllim për të patur një rezultat sa më të mirë dhe cilësor në mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e punimeve. Stafin teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm gjatë mbikëqyrjes së objekteve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për mbikëqyrjen sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe brenda kushteve të kontratës

Për të dokumentuar eksperiencën përvojën e stafit kryesor /profesional që zë pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkojnë kualifikimet arsimore (diplomat), kualifikimet profesionale (licencat profesionale), CV, Kontratë pune të vlefshme.

2.3.4. Numri i punonjësve: Numri i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 7 (shtate) punonjës për çdo muaj, për periudhën 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit, ndersa stafi tjetër mund të jete me kontrate shërbimi.

- Për të vërtetuar këtë kusht, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën për periudhën 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit, i cili duhet të përputhet me listë pagesat e punonjësve për këtë periudhë e vërtetuar kjo me listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve;

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

-Argumentim: Kërkesa është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur duke u bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të referencës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë listë pagesat e shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave shoqërore dhe shëndetësore me këtë kohështrirje është

dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

3. Mbeshtetje subjektive nuk lejohet për kriteret e mëposhtme:

-Për të provuar përvojën e mëparshme (shërbime të ngjashme):

Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

-Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës):

Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

Argumentimi ligjor: Në mbështetje të Nenin 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar; Nenin 88, Neni 90, pikat 5 dhe 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera sipas pikës 2.16 të DST-ve.

Argumentimi teknik: Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe realizimin e objektit me sukses dhe cilësi do të gjykojë mbi përvojën e mëparshme të operatorit i cili do të zbatojë këtë kontratë dhe jo në përvojën e një operatori tjetër, i cili i mbështet thjesht për t'u kualifikuar por nuk merr përsipër të kryej asnjë shërbim gjatë zbatimit. Do ishte një vlerësim jo korrekt nga ana e autoritetit nëse do lejonte mbështetjen në përvojë të ngjashme dhe operatori i cili do të fitonte kontratën nuk do të kishte përvojën e duhur, si dhe për më tepër të mbajë përgjegjësi për mos përmbushje të kontratës. Në rastin e një bashkimi operatorësh kërkesat për kualifikim, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuaranë aktmarrëveshje. Gjithashtu, lejimi i mbështetjes në subjekte të tjera përbën një risk shumë të madh për zbatimin e kontratës dhe përfundimin e saj me standard dhe cilësi. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas kriterëve të licencave. Duke u nisur nga këto fakte, gjykojmë se një operator ekonomik nuk do të realizonte me sukses zbatimin e kontratës në qoftë se nuk do të dispononte pikën e licencës për atë kategori dhe përvojën e ngjashme. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se AK nuk kufizon mundësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë për të përmbushur këto kriterë.

Argumentimi i Termave të Referencës

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Termet e references janë hartuar sipas standardeve dhe në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi dhe janë pjesë e pandare e DST. Ky dokument përmban Termet e Referencës (ToRs) për Shërbimin e Projektimit dhe Mbikëqyrjes me qëllim garantimin e cilësisë, përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe realizimin korrekt të projektit dhe mbikëqyrjes për: "Përmirësimi i transportit dhe aksesit nëpërmjet ndërhyrjeve në rrugët e bardha etj, Qarku (Elbasan, Korçë, Berat, Vlorë, Fier, Gjirokastrë)." Ndërhyrja është pjesë e Programit Operacional të FSHZH 2024-2030, miratuar nga Këshilli Drejtues i tij dhe konkretisht në detajimin financiar 2026-2029. Programi Operacional i FSHZH-së është një dokument planifikimi, i cili organizon në një plan operacional 7 vjeçar objektivat strategjike të institucionit, politikën e Qeverisë së Shqipërisë për Zhvillimin social-ekonomik, drejtimet e zhvillimit rajonal dhe kohezionit siç janë përcaktuar në Ligjin nr. 102/2020, si dhe programet aktive në zbatim dhe ato të dakorduara. Programi Operacional i FSHZH-së, ka përcaktuar 6 drejtimet kryesore ku do të fokusohen ndërhyrjet transformuese nga FSHZH në përmbushje të objektivave strategjike të zhvillimit rajonal.

Qëllimi i ndërhyrjes është përmirësimi i aksesit, funksionalitetit dhe sigurisë së rrjetit rrugor, me fokus të veçantë në zonat rurale dhe në segmentet ku infrastruktura ekzistuese paraqet problematika të dukshme teknike dhe funksionale. Ndërhyrja synon të garantojë lidhje më të mirë të komuniteteve me qendrat administrative, shërbimet publike, tregjet, institucionet arsimore dhe shëndetësore, si dhe të lehtësojë lëvizjen e përditshme të banorëve, mjeteve të transportit dhe mallrave. Përmes ndërtimit, rehabilitimit dhe konsolidimit të veprave të artit, mureve mbrojtëse, mureve pritëse, tombinove, sistemeve të kullimit dhe elementeve të tjera mbështetëse të infrastrukturës rrugore, synohet të rritet qëndrueshmëria e akseve rrugore dhe të reduktohen rreziqet që lidhen me rrëshqitjet, dëmtimet e trupit të rrugës, erozionin dhe mungesën e drenazhimit të përshtatshëm. Ndërhyrjet mund të përfshijnë, pa u limituar në: Rehabilitimi i zonave ku janë konstatuar rrëshqitje të terrenit, dëmtime të skarpave, deformime të trupit të rrugës apo cenim i qëndrueshmërisë së veprave ekzistuese të artit, duke parashikuar masa inxhinierike për stabilizimin e terrenit dhe rikthimin e funksionalitetit të plotë të segmentit rrugor. Riprofilimi i rrugës, përmirësimi i bazamentit, vendosja ose rforcimi i shtresave stabilizuese, si dhe trajtimi i zonave ku janë evidentuar deformime, gropa, çarje apo humbje të materialit rrugor. Sistemimi dhe përmirësimi i kullimit të ujërave, veçanërisht në zonat e banuara dhe në segmentet me pjerrësi të madhe gjatësore, për të shmangur dëmtimin e trupit të rrugës dhe të shtresave mbajtëse. Ndërtimi, pastrimi ose ribërja e kanaleve anësore kulluese, përmirësimi i drejtimit të rrjedhjes së ujërave, rehabilitimi i tombinove ekzistuese dhe realizimi i elementeve të nevojshme për largimin efikas të ujërave sipërfaqësore nga platforma rrugore. Pastrimi, sistemimi dhe ribërja, sipas rastit, e bankinave anësore, duke i trajtuar ato si elemente mbështetëse të trupit të rrugës që kontribuojnë në mbrojtjen e shtresave rrugore, përmirësimin e drenazhimit dhe rritjen e sigurisë së qarkullimit. Ndërtimi ose rehabilitimi i mureve mbajtëse dhe pritëse, përforcimi i elementeve mbrojtëse ekzistuese, si dhe ndërhyrje të tjera të nevojshme për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes së infrastrukturës. Përmirësimi i shtresave rrugore në bazë të gjendjes fizike dhe teknike të rrugës ekzistuese, kapacitetit mbajtës të nënshtresave, nivelit të dëmtimeve dhe intensitetit të përdorimit të segmentit. Kombinimi i ndërhyrjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me problematikat specifike të çdo segmenti, me qëllim përmirësimin e funksionalitetit, qëndrueshmërisë dhe sigurisë së akseve rrugore për komunitetet përfituese

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)¹ Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

1. Çmimi	pikët 50
2. Propozimi teknik	pikët 50
(i) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar	0 - 20

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

- | | | |
|-------|--|--------|
| (ii) | Metodologjia e Propozuar | 0 - 10 |
| | (Përqasja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative) | |
| (iii) | Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit | 0 - 20 |

1 Kriteri Çmimi [50] pike

Kriteri i cmimit me 50 pikë është i bazuar ne rregullat e prokurimit publik, ku parashikohet minimalisht 50 pike.

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç - Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Çmimi (në përputhje me kërkesat e VKM nr.354 datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit).

Llogaritja bëhet duke u mbështetur në VKM nr. 354, datë 11/05/2016 (Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim)

Vlera minimale pa tvsh 23,803,015 lekë, Vlera maksimale pa tvsh 27,185,372 lekë

Argumentimi: Kriteri i mësipër është përcaktuar bazuar në Nenin 45 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar

2 Kriteri Propozimi teknik [50] pike

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- i) **Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar / Projektim dhe Mbikqyrje**
[0- 20]

Nenkriteret

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm për projektim, mbikëqyrjen [5-20 %]

b- Eksperienca në fushën përkatëse projektim, mbikëqyrje [30-80 %]

Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.

Eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

- *Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Operatori Ekonomik për t’u vlerësuar për këte kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, ku cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës.

ii) Metodologjia e Propozuar / Projektim dhe Mbikqyrje

[0 – 10]

(Përqasja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

Nenkriteret

- | | |
|--|----------|
| ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia | [10-30%] |
| ii/b. Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projekti/objekt | [30-40%] |
| ii/c. Organizimi i Stafit | [10-30%] |

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme, duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit/objektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t’i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Stafi: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Metodologjia që ndiqet për realizimin e projekteve ka për qëllim të përfshijë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përjasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Metodologjia duhet të tregojë aftësinë për t’i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkrete. Përmbanë menaxhimin dhe përgjegjësitë kryesore të grupit të zbatimit të projektit. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull

Metodologjia që ndiqet për realizimin e mbikëqyrjes së punimeve synon të garantojë cilësinë e ndërtimit të objektit, të kontrollojë cilësinë e materialeve që do të përdoren në objekt referuar me specifikimet teknike të projektit, kontrollin e zbatimit të grafikut të punimeve, kontrollin sasior të volumeve të preventivit, si dhe zgjidhjen e problemeve teknike apo organizative që dalin gjatë zbatimit të punimeve në objekt. Metodologjia do të ketë një rol të rëndësishëm në zbatimin e projektit. Metodologjia prezanton gjithashtu detyrat dhe strukturën organizative të grupit të zbatimit të punimeve..

(iii) Përvoja për Punë të Ngjashme të Projektuesit/ Mbikqyresit [0 – 20]

Nënkriteret

iii/a Përvoja për punë të ngjashme projektues, mbikëqyrës 40-80%

Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

iii/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 10-20%

Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të ligjit 162/2020, Referuar në nenin 79 parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë” dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Certifikata e standardeve të cilësisë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar $Pk1/Pk2/Pk3/\dots$ - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përlogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmin k1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

$Vmin k1$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$Pmaxk1$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

$$\text{Oferta më e mirë } Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Piket dhe pesha e vendosur për secilin nenkriter gjatë zhvillimit të fazës së minikonkursit, do të variojnë brenda kufijve të përcaktuar më sipër.